




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport
Direkcija za Kulturou Omladinu i Sport
Department of Culture Youthand Sports

Thirrje Publike

Për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/ programeve të OJQ-ve dhe Individëve në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

1. Komuna e Skenderajit përkatësisht Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport, u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare, individëve dhe klubeve sportive të regjistruara në Komunën e Skenderajit , programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zhvillimin e kulturës , rinisë dhe sportit në Komunën e Skenderajit.
2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekte /programet e tyre për Aktivitetet e mëposhtme :
 - Shoqëritë amatore
 - Festalet
 - Botimi i librave/shkrimeve letrare
 - Ekspozitë me fotografi
 - Aktivitetet me karakter garues
 - Aktivitetet rinore
 - Fushatat Vetëdijesuese
 - Pjesëmarrje në festivale jashtë komunës / shtetit
 - Promovimi i librave
 - Promovimi i talenteve të rinjë
 - Trashëgimi Kulturor

- Shfaqje teatrale
- Klubet Sportive (pagesat e regjistrimit të Klubeve në Federatë përkatëse, kuotizimit, referimit, transportit dhe të ushqimit për ndeshjet zyrtare)
- Aktivitetet sportive me karakter garues

3. Organizatat jo-qeveritare mund të aplikojnë vetëm me nga një projekt në kuadër të kulturës, rinisë dhe sportit i cili do të përfshijë dhe kontribuojë në promovimin e aktiviteteve të parapara me pikën 2 të kësaj thirrje publike.

4. Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për çdo projekt individual është 500.00 Euro, ndërsa shuma maksimale varet nga projekti dhe numri i aplikimeve

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune nga dita e publikimit të thirrjes publike, përkatësisht dita e fillimit është 23/01/2026, ndërsa dita e fundit për dorëzimin e propozimit është me datën 12/02/2026.

Vlera totale e thirrjes publike është 150,000.00 Euro

6. Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e Organizatave Joqeveritare të Republikës së Kosovës me seli në territorin e Komunës së Skenderajt dhe të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre dhe janë të regjistruara së paku një vit para datës së publikimit të thirrjes publike, përiudha e zbatimit të projektit është fundi i vitit aktual.

OJQ-të aplikuese duhet të deshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën të cilën aplikojnë, si dhe të paraqesë dëshmi se gjatë një viti është marrë me organizimin e ngjarjeve kulturore, aktiviteteve rinore dhe sportive. Nëse kanë qenë përfituese e mjeteve financiare të ndara nga Komuna Skenderaj, të justifikojnë mjetet e shpenzuara duke dorëzuar raportin financiar.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ-të duhet të paraqesin prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të paguara, nëse është e aplikueshme.

Të njëjtat dëshmi duhet të i dorëzojë edhe personi fizik i cili është përfitues i mbështetjes financiare.

7. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e parapara, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të Komunës së Skenderajt kk.rks-gov.net/Skenderaj.

Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në zarf të mbyllur në arkiven e komunës në adresës: “Komuna Skenderaj, rruga 28 Nentor 41000”- Skenderaj

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimi të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimin për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e percaktuara të thirrjes publike.

Lista e dokumenteve që duhet t'i bashkangjitet formularëve nga ana e aplikuesve janë si vijon:
Për OJQ-të:

- Çertifikaten e regjistrimit të OJQ-së
- Çertifikata e nr. Fiskal
- Vërtetimi/Konfirmimi i llogarisë bankare të OJQ-së (nuk pranohet kopje e kartelës bankare)
- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës të përfaqësuesit të OJQ-së
- Vërtetimin/Marrëveshjen që OJQ nuk ka obligime tatimore (nga ATK)
- Deklaratën për financim të dyfishtë.

Vërejtje/Kujdes: Të gjitha aplikimet të cilat nuk do të kenë dokumentacionin e kompletuar nuk do të merren parasysh.

8. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike duke dërguar e-mail në adresën: komuna.skenderaj@rks-gov.net

Skenderaj, 23.01.2026



Udheheqësi për Kulturë Rini dhe Sport

Faton Zekaj